

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **205-21-2663-2-1-1**

Sa i përket tenderit për MIRËMBAJTJA VERORE DHE MIRËMBAJTJA DIMRORE 2021 2022 E RRUGËVE NACIONALE DHE RAJONALE

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

VIA SHPK  
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr"Mehtmet Gradica" PN, Gërlicë  
(Adresa)

Ferizaj 70000  
(Vendi) (Kodi postar)

049920000  
(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

Drilon Shamolli  
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)  
info@via-ks.com  
(Adresa elektronike)

21.07.2021  
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës



#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

\_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:*

**Titulli i tenderit Mirembajtja Verore dhe Dimerore 2021-2022 e rrugeve Nacionale dhe Rajonale. Numri i Prokurimit: 205-21-2663-2-1-1 I publikuar ne e-prokurim me date 05.05.2021**  
**31.05.2021 Data e dorezimit dhe hapjes se tendereve ne faqen e e-prokurimit**  
**01.07.2021 Data e njoftimit permes faqes se e-prokurimit ne lidhje me eliminimin nga tenderi ne fjale.**  
**04.07.2021 Dorezimi permes e-prokurimit te Kerkeses per Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues & permes e-mailit**  
**07.07.2021 – Vendimi i AK per Pezullimin e Aktivitetit te Prokurimit**  
**13.07.2021 Pergjigja nga Autoriteti Kontraktues permes e-prokurimit**

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☒

Jo ☐

Hapja e tendereve te operatoreve ekonomik eshte bere me date 31.05.2021 ne faqen e e-prokurimit dhe procesi i hapjes ka qene i rregullt.

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Kerkesa prane Autoriteti Kontraktues eshte dorezuar permes platformes se e-prokurimit me date 04.07.2021 dhe gjithashtu permes e-mailit me date 05.07.2021. Te bashkangjitur gjeni kopjen e Kerkeses per Rishqyrtim dhe e-mailin e derguar

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

**Ligji Nr. 04/L-042, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092**

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi 1, paragrafi 4, paragrafi 6. Neni 4 i RRUOPP paragrafi 4.1, paragrafi 4.4

Neni 10 – Mjetet për promovimin e transparencës

Neni 27/A Ndarja e kontratave në Lote paragrafi 2. Neni 19 i RRUOPP paragrafi 19.3

Neni 51 – Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes

Neni 56 – Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, paragrafi 3, paragrafi 4

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1

Neni 65 – Pranueshmeria e Kandidatëve ose Tenderuesve, Neni 26 i RRUOPP

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale paragrafi 4 nënparagrafi 4.1, 4.5, paragrafi 6 nënparagrafi 6.1, 6.3.

Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë paragrafi 1 paragrafi 2, paragrafi 3

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi 1, paragrafi 4, paragrafi 6. Neni 4 i RRUOPP paragrafi 4.1, paragrafi 4.4

- Autoriteti kontraktues nuk i ka trajtuar operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo

diskriminuere duke shpallur fitues operatore ekonomik per Ferizaj 1 qe nuk i plotesojne kushtet dhe kritret per dhenien e tenderit sipas kriterëve dhe kushteve ne dosjen e tenderit ne fjale.

- AK duke shpallur fitues keta operatore ekonomik qe nuk plotesojne kriteret dhe kushtet sipas dosjes se tenderit ka krijuar diskriminim material, personal dhe organizativ ndermjet operatorëve ekonomik.
- AK ka perdorur standarte te dyfishta ne procesin e perzgjedhjes dhe dhenies te tenderit ku operatorët ekonomik qe i ka shpallur fitues per lotet e lartepemendura nuk i kane plotesuar te gjitha aspektet permbajtësore te kushteve, kriterëve dhe specifikimeve perkatese sic jane kerkuar ne dosjen e tenderit si dhe AK i ka interpretuar keto kriterë ashtu sic eshte pershtatur me mire per te shpallur fitues kompanite qe nuk permbushin kriteret.

## • Verejtja 1

*1.1 - Ne letren standarte per tenderusin e eliminuar te dhene nga AK per ne si OE "VIA shpk & EUOKOS HOLDING shpk" ka shkruar: OE, nuk ka ofruar deshmi mbi kapacitetin e paisjeve, sipas kerkesave te FDT-se te DT Neni 9.1 dhe 9.2 pika 5 – Lista e paisjeve*

*OE ka te prezantuar listen e paisjeve te noterizuara nga Noteri sipas procedures enminutes, mirepo nuk ka prezantuar asnje deshmi mbi pronesine e ketyre paisjeve (pervec disa foto te pozicionit nr V.2 pika 2 paisjet Dimerore) sipas kerkesave te DT lista e paisjeve Nr V pika V.1 dhe V.2 mungojne te dhenat per paisjet dhe deshmitë, Librezat mbi regjistrimin, DUD-at Doganor, faturat, viti i prodhimit.*

## SQARIM I VEREJTJES 1

- 1.2 - Ne si OE "VIA shpk & EUOKOS HOLDING shpk" e kemi te paraqitur listen e paisjeve dhe te prezantuar sipas kerkesave te dosjes se tenderit Neni 9.1 dhe 9.2 pika 5 – Lista e paisjeve Procesverbalit per Konstatim te Gjendjes Juridike dhe Faktike Per Mjetet Motorike, Mjete te Punes dhe Mjete te Tjera te leshuar nga Noter Selatin D. Shahini permban te gjitha te dhenat e nevojshme se si jane identifikuar makineria perpara Noterit te cilet jane identifikuar permes librezave, faturave, Dudave, Kontratave etj te gjitha keto te prezantuara nga ne si OE tek Noteri dhe i njejti i ka verifikuar dhe i ka konstatuar dhe gjendjen e tyre faktike ne terren. Ne Nenin 3 te Procesverbalit te Noterit shkruan: Neni 3 Identifikimi i Makinerise dhe ku jane te dhenat per secilen makineri se si eshte deshmuar nga ne si OE te cilat kane qene permes librezave te regjistrimit, faturave, DUDA-ve, marreveshjeve, kontratave etj. Neni 4 i Proserverbalit te Noterit shkruan : *Neni 4 Konstatim: 1. Noteri konstaton se i tere dokumentacioni ne origjinal duke konfirmuar pronesine dhe posedimin e ketyreve mjeteve motorike, mjeteve te punes dhe mjeteve tjera, z. Drilon Shamolli ne cilesine te perfagesuesit te konzorciumit "VIA" shpk & EUOKOS HOLDING SHPK' i ka prezantuar para meje duke i deshmuar ato edhe me nga nje foto per secilin mjet motorik, mjet te punes apo mjet tjeter, andaj noteri ne baze te dokumentacionit te prezantuar nga i njejti dhe me shikimin e ketyre mjeteve ne terren konstaton se keto mjete motorike, mjete te punes dhe mjete tjera jne ne pronesi – posedim te konzorciumit "VIA SHPK & EUOKOS HOLDING SHPK (shih te bashkangjitur proserverbalin)*
- 1.3 - Ne si OE mendojme dhe besojme se AK ka shkelur Ligjin sepse ky kriter ka qene i permbushur nga ne si OE per arsye se te gjithë dokumentacionin qe kemi deshmuar qe posedojme makinerine e kemi te dorezuar tek Noteri dhe do t'ju bashkangjisim Proserverbalin te cilin e kemi terhequr nga Noteri ku permban te gjithë dokumentacionin se si jane deshmuar makinerine, paisjet dhe mjetet e punes. AK duhet ta kete parasysh se ne jemi shpallur fitues dhe kemi kontrate aktive me AK ne lidhje me Projektin "Mirembajtja Verore dhe Dimerore e Rrugeve Nacionale dhe Regjionale te Kosoves 2018-2019-2020, Regjioni Ferizaj 1 dhe ku me te njejtin proserverbal te Noterit ne jemi shpallur fitues dhe jemi kontraktor te asaj Kontrate andej AK nuk duhet te perdori standarte te dyfishta dhe te interpretoj kriteret sipas interesave te AK. (Bashkangjitur gjeni dokumentin me emeritim: 1.1Kontraten E Mirembajtjes Verore dhe Dimerore e Rrugeve Nacionale dhe Regjionale te Kosoves 2017-2018-2019, Regjioni Ferizaj 1 gjithashtu edhe dokumentin me emertim: 1.2Procesverbalin e Noterit per tenderin e fituar dhe kontraten e nenshkruar ne fjale)
- 1.4 - AK ka shkelur ligjin duke perdorur kriterin e mesiperm si argument edhe pse jo valid per te na eliminuar ne si OE te pergjegjshem me cmimin me te ulet.
- 1.5 - Bashkangjitur gjeni dokumentin me pershkrimin: 1.3Procesverbal - VIA SHPK - 25.05.2021 me te gjitha shtojcat

## • VEREJTJA 2

*2.1 - Ne letren standarte per tenderusin e eliminuar te dhene nga AK per ne si OE "VIA shpk & EUOKOS HOLDING shpk" ka shkruar: Tek kerkesat mbi mundesite teknike dhe profesionale Neni 9.1 dhe 9.2 pika 1-4 – OE "EUOKOS HOLDING shpk" ka leshuar referenca per stafin profesional (1. Lulzim Muharremi, Dafina Tmava, Florim Shala dhe Veton Piraj ne emer te kompanise "NTP EUOKOS nga Shqiperia", ndersa vula eshte e kompanise "EUOKOS HOLDING shpk" nga Prishtina qe jane jo valide.*

## SQARIM I VEREJTJES 2

- 2.2 - Ne referencat e lartepemendura dhe ne lidhje me vulen ne sqarojme AK ne rradhe te pare se nuk eshte NTP EUOKOS nga Shqiperia" por eshte "NTP EUOKOS dega ne Shqiperi" dhe kjo

nenkupton se “NTP EUROKOS dega ne Shqiperi” eshte dege e “EUROKOS HOLDING SHPK” me zyre qendrore ne Kosove dhe se cdo dokumentacion dhe vule eshte e vlefshme sikurse dega e saj ne Shqiperi. “NTP EUROKOS dega ne Shqiperi” dhe “EUROKOS HOLDING SHPK eshte e njejta kompani vecse ka degen e saj ku operon dhe ne Shqiperi dhe cdo vule eshte e vlefshme pavarisisht se ne cilin vend eshte leshuar. Inxhinieret mund te punojne ne cdo vend te botes dhe kerkesen e kane bere per reference tek kompania qendore ne Kosove andaj edhe vula eshte e leshuar nga “EUROKOS HOLDING SHPK” Per kete gje po ju bashkangjism dokumentet me pershkrimin: 2.1 Certifikaten e Biznesit te NTP EUROKOS-Dega ne Shqiperi, Licencen dhe ekstraktin, ku argumenton qe eshte Dege e Shoqerise se Huaj dhe deshmon se firma kryesore eshte EUROKOS HOLDING shpk ne Kosove.

- 2.3 - AK ka shkelur ligjin sepse ne argumentin e perdorur per referencat e inxhinierëve ka permendur te gjithë inxhinieret Lulzim Muharremi, Dafina Tmava, Florim Shala dhe Veton Piraj kurse ne realitet reference me vule te EUROKOS HOLDING shpk – dega ne Shqiperi kane vetem Lulzim Muharremi dhe Florim Shala dhe jo dy inxhinieret e tjere Dafina Tmava dhe Veton Piraj.
- 2.4 - AK ka shkelur ligjin sepse edhe ne qoftese do te merrnim per baze se vertete nuk jane valide vula gje qe e cila nuk qendron atehere inxhinieret ne fjale kane pasur mjaftueshem referenca nga kompanite e tjera te cilat kane permbushur kushtet dhe kriteret sipas DT andaj ky kriter eshte plotesuar nga ne si OE megjithate AK thjesht ka kerkuar nje argument edhe pse jo valid per te na eliminuar ne si OE te pergjegjshem me cmimin me te ulet. (shih te bashkangjitur referencat e tjera te inxhinierëve ku shihet se kriteri ka qene i plotesuar edhe sikurse te ishin jo valide referencat nga NTP EUROKOS dega ne Shqiperi).
- 2.5 - AK nese do te kishte perdorur si pretekst per eliminimin nga tenderi vulen e EUROKOS HOLDING shpk dhe NTP EUROKOS Dega ne Shqiperi” atehere i njejti pretekst per te eliminuar edhe OE SALLAHU SHPK sepse cdo kontrate dhe marreveshje para dates 22.06.2018 edhe me ju si AK ky OE i ka me vulen dhe biznesin NNT SALLAHU. (bashkangjitur gjeni dokumentin me pershkrimin: 21.1 Kontratat e Realizuar, Pjesa 4\_NNTSALLAHU dhe SALLAHU shpk, qe e ka te nenshkruar si NTP SALLAHU edhe me pas si SALLAHU shpk
- 2.6 - Bashkangjitur gjeni dokumentin me pershkrimin: 2.2 Referencat\_Lulzim Muharremi\_Florim Shala
- 2.7 - Bashkangjitur gjeni dokumentin me pershkrimin: 2.3 Referencat\_Veton Pira\_Dafina Tmava

#### • VEREJTJA 3

Neni 27/A Ndarja e kontratave ne Lote paragrafi 2. Neni 19 i RRUOPP paragrafi 19.2, paragrafi 19.3

- 3.1 - AK ka bere ndarjen ne Lote te ketij tenderi dhe ka vendosur si kriter ne DT pika 2.5 Ndarja ne Lote se numri maksimal qe do te mund te shperblehen tek nje tenderues eshte 1 (Nje) dhe se ne piken 9.1 dhe 9.2 Kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale tek Deshmia e kerkuar dokumentare ka vendosur si kriter *Leternjoftimi – kopje, nëse OE aplikon me shume se dy pjese (lot) atëherë duhet te ofrohet stafi edhe per aq lote sa konkuroi.*
- 3.2 - AK ka shkelur ligjin sepse shume OE kane marre pjese ne shume Lote me vetem 1 staf teknik dhe profesional.
- 3.3 - AK ka shkelur Nenin 19 te RRUOPP paragrafi 19.3 ku nder te tjera thote “Ne rast se Tenderuesi ofron cmimin me te ulet ne me shume se 1 Lot atehere ai do te shperblehet me kontrate per Lotin qe ka vleren totale te pergjithshme me te larte”. Ne rastin e Lotit Ferizaj 1 dhe Lotit Prishtine 1 meqenese AK e ka konsideruar te pergjegjshem me cmimin me te ulet OE SALLAHU & SALILLARI atehere ky OE duhet te ishte shpallur fitues ne Lotin Prishtina 1 duke qene se ka qene OE me cmimin me te ulet te pergjegjshem dhe me vleren totale te pergjithshme me te larte se ne Lotin Ferizaj 1. Ne lotin Prishtina 1 OE SALLAHU & SALILARRI vlere e pergjithshme eshte 773,789.53 EUR ndersa ne Lotin Ferizaj 1 vlere totale e pergjithshme eshte 449,960.43 EUR. Kete kriter AK ka shfrytezuar ne rastin e Loteve Gjakova 1 dhe Gjakova 2 duke shperblyer OE PAPENBURG & FIDAIE BYTYQI i pergjegjshem me cmimin me te lire ne Lotin Gjakova 1 me vlere totale 540,096.17 edhe pse i njejti OE PAPENBURG & FIDAIE BYTYQI ka qene i pergjegjshem me cmimin me te lire ne Lotin Gjakova 2 me vlere 494,402.69 EUR dhe gjithashtu po prap i njejti OE PAPENBURG & FIDAIE BYTYQI ka qene i pergjegjshem me cmimin me te lire ne Mitrovica 2 me vlere totale 484,212.45 EUR. Kete kriter AK ka shfrytezuar ne rastin e Loteve Prizren 2 dhe Prishtina 2 duke shperblyer OE 2A GROUP & ABC i pergjegjshem me cmimin me te lire ne Lotin Prizren 2 me vlere totale 744,744.78 edhe pse i njejti OE 2A GROUP & ABC ka qene i pergjegjshem me cmimin me te lire ne Lotin Prishtina 2 me vlere totale 594,777.86 EUR. AK nuk duhet te perdori standarte te dyfishta ne zbatimin e ligjeve te prokurimit dhe udhezuesit te prokurimit publik per te shperblyer disa OE dhe disa te tjere duke i eliminuar.  
[Bashkangjitur gjeni dokumentin me pershkrimin: AK\\_3\\_Njofitim mbi vendimin MVD 2021-2022](#)

#### • VEREJTJA 4

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, paragrafi 3, paragrafi 4

- 4.1 - Ne si OE “VIA shpk & EUROKOS HOLDING shpk” e kemi te paraqitur listen e paisjeve dhe te prezantuar sipas kerkeseve te dosjes se tenderit Neni 9.1 dhe 9.2 pika 5 – Lista e paisjeve Procesverbalit per Konstatim te Gjendjes Juridike dhe Faktike Per Mjetet Motorike, Mjete te Punes dhe Mjete te Tjera te leshuar nga Noter Selatin D. Shahini permban te gjitha te dhenat e nevojshme se si jane identifikuar makineria perpara Noterit te cilet jane identifikuar permes librezave, faturave, Dudave, Kontratave etj te gjitha keto te prezantuara nga ne si OE tek Noteri dhe i njeiti i ka verifikuar dhe i ka konstatuar dhe gjendjen e tyre faktike ne terren. Ne Nenin 3 te Procesverbalit te Noterit shkruan: Neni 3 Identifikimi i Makinerise dhe ku jane te dhenat per secilen makineri se si eshte deshmuar nga ne si OE te cilat kane qene permes librezave te regjistrimit, faturave, DUDA-ve, marreveshjeve, kontratave etj. Neni 4 i Proserverbalit te Noterit shkruan : *Neni 4 Konstatim: 1. Noteri konstaton se i tere dokumentacioni ne origjinal duke konfirmuar pronesine dhe posedimin e ketyreve mjeteve motorike, mjeteve te punes dhe mjeteve tjera, z. Drilon Shamolli ne cilesine te perfagesuesit te konzorciumit “VIA” shpk & EUROKOS HOLDING SHPK’ i ka prezantuar para meje duke i deshmuar ato edhe me nga nje foto per secilin mjet motorik, mjet te punes apo mjet tjeter, andaj noteri ne baze te dokumentacionit te prezantuar nga i njeiti dhe me shikimin e ketyre mjeteve ne terren konstaton se keto mjete motorike, mjete te punes dhe mjete tjera jne ne pronesi – posedim te konzorciumit “VIA SHPK & EUROKOS HOLDING SHPK - Bashkangjitur gjeni fajllin me pershkrimin: 1.Procesverbal - VIA SHPK - 25.05.2021 me te gjitha shtojcat.*
- 4.2 - Ne si OE mendojme dhe besojme se AK ka shkelur Ligjin sepse ky kriter ka qene i permbushur nga ne si OE per arsye se te gjitha dokumentacionin qe kemi deshmuar qe posedojme makinerine e kemi te dorezuar tek Noteri dhe do t’ju bashkangjisim Proserverbalin te cilin e kemi terhequr nga Noteri ku permban te gjitha dokumentacionin se si jane deshmuar makinerine, paisjet dhe mjetet e punes. AK duhet ta kete parasysh se ne jemi shpallur fitues dhe kemi kontrate aktive me AK ne lidhje me Projektin “Mirembajtja Verore dhe Dimerore e Rrugeve Nacionale dhe Regjionale te Kosoves 2018-2019-2020, Regjioni Ferizaj 1 dhe ku me te njejtin proserverbal te Noterit ne jemi shpallur fitues dhe jemi kontraktor te asaj Kontrate andej AK nuk duhet te perdori standarte te dyfishta dhe te interpretoj kriteret sipas interesave te AK.
- 4.3 - AK ka shkelur ligjin duke perdorur kriterin e mesiperm si argument edhe pse jo valid per te na eliminuar ne si OE te pergjegjshem me cmimin me te ulet.
- 4.4 - Ne referencat e lartepermendura dhe ne lidhje me vulen ne sqarojme AK ne rradhe te pare se nuk eshte NTP EUROKOS nga Shqiperia” por eshte “NTP EUROKOS dega ne Shqiperi” dhe kjo nenkupton se “NTP EUROKOS dega ne Shqiperi” eshte dege e “EUROKOS HOLDING SHPK” me zyre qendrore ne Kosove dhe se cdo dokumentacion dhe vule eshte e vlefshme sikurse dega e saj ne Shqiperi. “NTP EUROKOS dega ne Shqiperi” dhe “EUROKOS HOLDING SHPK eshte e njejta kompani vecse ka degen e saj ku operon dhe ne Shqiperi dhe cdo vule eshte e vlefshme pavarsisht se ne cilin vend eshte leshuar. Inxhinieret mund te punojne ne cdo vend te botes dhe kerkesen e kane bere per referenve tek kompania qendore ne Kosove andaj edhe vula eshte e leshuar nga “EUROKOS HOLDING SHPK” (shih te bashkangjitur dokumentat e regjistrimit te biznesit NTP EUROKOS dega ne Shqiperi ku verteton se eshte dege e EUROKOS HOLDING nga Kosova)
- 4.5 - AK ka shkelur ligjin sepse ne argumentin e perdorur per referencat e inxhinierëve ka permendur te gjitha inxhinieret Lulzim Muharremi, Dafina Tmava, Florim Shala dhe Veton Piraj kurse ne realitet reference me vule te EUROKOS HOLDING shpk kane vetem Lulzim Muharremi dhe Florim Shala dhe jo dy inxhinieret e tjere Dafina Tmava dhe Veton Piraj.
- 4.6 - AK ka shkelur ligjin sepse edhe ne qoftese do te merrnim per baze se vertete nuk jane valide vula gje qe e cila nuk qendron atehere inxhinieret ne fjale kane pasur mjaftueshem referenca nga kompanite e tjera te cilat kane permbushur kushtet dhe kriteret sipas DT andaj ky kriter eshte plotesuar nga ne si OE megjithate AK thjesht ka kerkuar nje argument edhe pse jo valid per te na eliminuar ne si OE te pergjegjshem me cmimin me te ulet. (shih te bashkangjitur dokumentacionet me pershkrimin: 2.2Referencat\_Lulzim Muharremi\_Florim Shala dhe 2.3.Referencat\_Veton Pira\_Dafina Tmava)
- 4.7 - AK nese do te kishte perdorur si pretekst per eliminimin nga tenderi vulen e EUROKOS HOLDING shpk dhe NTP EUROKOS Dega ne Shqiperi” atehere i njeiti pretekst per te eliminuar edhe OE SALLAHU SHPK sepse cdo kontrate dhe marreveshje para dates 22.06.2018 edhe me ju si AK ky OE i ka me vulen dhe biznesin NNT SALLAHU. NNT SALLAHU. (bashkangjitur gjeni dokumentin me pershkrimin: 21.1Kontratat e Realizuara, Pjesa 4\_NNTSALLAHU dhe SALLAHU shpk, qe e ka te nenshkruar si NTP SALLAHU edhe me pas si SALLAHU shpk

## • VEREJTJA 5

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës, paragrafi 1 nen paragrafi 1.1

- 5.1 - AK ka shkelur ligjin duke mos na shpallur ne si OE per tenderin e pergjegjshem me cmimin me te ulet per Ferizaj 1



## SQARIM I VEREJTJES 5

- 5.2 - AK ka shkelur ligjin duke shpallur te pergjegjshem OE SALLAHU & SALILLARI per Lotin Ferizaj 1 duke qene se stafi nuk eshte i ndare se per cilat Lote konkuron dhe eshte perdorur i njejti staf edhe pse ka staf te mjaftueshem per te dyja lotet dhe nuk ka pershkrim tek referencat per menagjimin e kontratave te ngjashme ne vlere 300,000.00 EUR ne asnjeren prej inxhinierëve te OE SALLAHU & SALILLARI . *Bashkangjitur gjeni dokumentin ku deshmon se asnjë nga inxhinieret e paraqitur nuk eshte ne listen e pagave, dokumenit me pershkrimin: 3.1Inxhinieret e Ndertimi dhe Lista e Pagave\_Sallahu\_Salillari dhe 3.2.Inxhinieret e Komunikacionit dhe Lista e Pagave\_Sallahu\_Salillari*

## • VEREJTJA 6

Neni 65 – Pranueshmeria e Kandidateve ose Tenderuesve, Neni 26 i RRUOPP

6.1 - AK ka bere shkelje duke shpallur fitues OE SALLAHU & SALLILLARI duke qene se ne DT pika 6 Pershtatshmeria e Operatoreve Ekonomik paragrafi 6.2 *Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ose ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të fundit:*

- a. *është shpallur fajtorë nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, mitosjen, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në nenin 130.1 të LPP-se sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë ose në cilindo shtet, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;*
- b. *është deklaruar i papërshtatshëm, kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rende profesionale, e konstatuar nga një gjykatë kompetente;*
- c. *është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale serioze të pjesëmarrjes në aktivitetet e një organizate kriminale, që përkufizohet si asociacion i strukturuar dhe i krijuar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të përfitimit financiar përmes veprimeve që konsiderohen si kriminale ose të kundërligjshme në vendin ku ndodhin ato; ose*
- d. *është shpallur fajtor për mashtrim apo një akt të ngjashëm me mashtrim nga një gjykatë kompetente;*
- e. *është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale; ose*
- f. *është konstatuar nga një gjykatë kompetente se ka bërë keqinterpretime para autoriteteve publike në Kosovë ose diku tjetër.*

## SQARIM I VEREJTJES 6

- 6.2 - AK ka shkelur nenin 65 te LPP dhe Nenin 26 te RRUOPP duke shpallur fitues OE SALLAHU & SALLILLARI duke qene se OE SALLAHU dhe se drejtuesi i saj z. Naim Sallahu para dates 25.06.2018 me kompanine N.N.T SALLAHU ku edhe ne certifikaten e biznesit tek informatat mbi biznesit te OE SALLAHU shpk shkruan “SALLAHU shpk ka bere nderrim tipit te biznesit me dt 22.06.2018 nga SALLAHU B.I (pronar Naim Sallahu) me NRB 80021194 ka kaluar SALLAHU shpk me NUI 810135237” . Pronari/drejtori i kompanise SALLAHU B.I para dates apo SALLAHU SHPK pas dates 25.06.2018 ka qene i denuar dhe ka pranuar fajesine per falsifikim te dokumentit duke fshehur obligimet tatimore ndaj ATK ku gjykata ka aprovuar marreveshjen ne lidhje me pranimin e fajesise e arritur ndermjet prokurorit Berisha dhe te akuzuarit z. Naim Sallahu. Referojuni linkut te bashkangjitur te portalit informativ Betimi per Drejtesi betimiperdrejtesi.com/vecohet-procedura-ndaj-te-pandehurit-per-falsifikim-te-dokumentit-ne-rastin-ku-te-akuzuar-jane-dy-edhe-zyrtare-te-mi-se/

Duke u bazuar ne Nenin 65 ku thote citoj: 2 *Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ose ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të fundit; pavarisist se nga 25.06.2018 pronar eshte Lulzim Sallahu dhe para kesaj date ka qene Naim Sallahu atehere drejtuesi i saj ka qene i denuar ne 10 vitet e fundit.*

- 6.3 - AK ka shkelur ligjin duke shpallur fitues OE SALLAHU & SALLILLARI duke qene se ne DT tek Kerkesat e pershtatshmerise pika:
    - b) *Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.*
    - c) *Vërtetim nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike - Një dokument të lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush “Kërkesat e pershtatshmerise” - të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës*
    - d) *Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme*
- Deshmia e kerkuar: Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen nga tenderuesi fitues, para publikimit të*

*dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet dhe Autoritetit Kontraktues do të vazhdojë tenderuesin e listuar në vendin e dytë.*

- 6.4 - AK ka shkelur ligjin duke qene se asnjeri nga OE ne konzercium si SALLAHU ashtu edhe SALLILLARI nuk kane te dorezuar ndonje dokument te sipermendur. [\(shih te bashkangjitur gjeni dokumentin me pershkrimin: 4.1E-mail i derguar i dates 04.07.2021\\_AK\\_per Vertetime](#)

- **VEREJTJA 7**

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale paragrafi 4 nenparagrafi 4.1, 4.5, paragrafi 6 nenparagrafi 6.1, 6.3.

- 7.1 - AK ne DT tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 pika 11 Plani i menaxhimit dhe pastrimit sa më i detajuar Plani dinamik sa më i detajuar (gantogrami) , dhe te Specifikimet e Mirembajtjes Dimerore Cilesia e Sherbimeve faqe 2 dhe 3 eshte kerkuar te paraqitet:

- 1.Hartën e rrjetit rrugor për regjionin e Lotit për të cilin konkurron ku është specifikuar qarte vendndodhja e bazës së mirëmbajtjes.
- 2.Skema e rrjetit rrugor të ndare për regjionin e Lotit për të cilin konkurron në disa varg rrjetesh për secilin kamion.
- 3.Rrugëtimet e paraqitura grafikisht për një kamion të caktuar (te numëruar) duke ndare gjatësitë e rrugëve të vdekura (vijëzim i ndërprerë) nga gjatësitë e rrugëve efektive (vijëzim i pandërprerë).
- 4.Tabelat përkatëse me të dhënat e gjatësive të rrugëtimeve (te vdekura dhe efektive) për secilin kamion dhe kohen e llogaritur (koha e reagimit) qe i duhet kamionit për të shkuar në vendin e kryerjes se shërbimit për secilin kamion.
- 5.Shpejtësia mesatare e udhëtimit të kamionit për llogaritje duhet te merret 30 km/ore. Koha maksimale e reagimit llogaritet duke pjestuar gjatësinë maksimale te rrugës së vdekur me shpejtësinë e dhënë mesatare.
- 6.Koha maksimale e Reagimit për regjionin që mbulon Loti përkatës nuk duhet të kaloje vlerën 1.5 orë.
- 7.Koha maksimale e llogaritur simbas udhëzimeve të mësipërme përbën një nga nën kriteret e vlerësimit të Ofertës tuaj.

*Mosparaqitja e dokumenteve të mësipërme përjashton ofruesin e shërbimeve nga vlerësimi i mëtejshëm i tenderit te tij (kriteret e përshtatshmërisë).*

- **SQARIM I VEREJTJES 7**

- 7.2 - AK ka shkelur ligjin duke shpallur fitues OE SALLAHU & SALLILLARI i cili nuk kane paraqitur asnjeren nga 7 pikat e larteshenuara te cilat jane detajet thelbesore per Mirembajtjen Dimerore sipas Specifikacioneve Teknike. [\(Bashkangjitur gjeni faqen 1,2 dhe 3 nga Specifikacionet Teknike Dimerore\) me pershkrimin: 5.1Specifikimet Mirëmbajtjes Dimërore 2021-2022\\_3faqe](#)
- 7.3 - AK ka shkelur ligjin duke shpallur fitues OE SALLAHU & SALLILLARI te cilit i Mungon Plani i Menaxhimit te Trafikut i duhet bere nga Ing.Komunikacionit. O.E ne dokumentin “Metodologjia e punimeve kane theksuar citoj: Menaxhimi I Trafikut: Gjate ndertimit te shtreses asfaltike, trafiku nuk do te lejohet derisa procesi I shtresezimit te perfundoje. Trafiku do te menaxhohet duke perdorur sinjalistika pergjate rruges. Te gjitha punimet e shtrese asfaltike do te kryhen ne perputhje te plote me Rregullat dhe Standardet e Sigurise, ne menyre te sakte, sipas dokumentit manual “Udhëzimeve operative per menaxhimin dhe mirembajtjen e rrugeve” me kete fjali perfundon PLANI I MENAXHIMIT TE TRAFIKUT. Ky dokument nuk eshte I nenshkruas as nga Ing. I Komunikacionit. [Bashkangjitur gjeni dokumentin me pershkrimin: 5.1.Metodologjia, Menaxhimi Trafikut\\_Sallahu\\_Sallillari](#)
- 7.4 - AK ka shkelur ligjin duke shpallur fitues OE SALLAHU & SALLILLARI i cili Planin dinamik sa me i detajuar - si kriter ne DT tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 pika 11. O.E. ofertues kane paraqitur nje Plan Dinamik te pa detajuar duke i specifikuar vetem 5 pozicione te punimeve ne Mirembajtjen Verore dhe 5 pozicione te punimeve ne Mirembajtjen Dimerore ndersa ne paramasen dhe parallogarine kane qene 78 pozicione te punimeve. Per te bere krahasimin po ju bashkangjisim planin dinamik te punimeve sipas kerkesave te AK. [Bashkangjitur gjeni dokumentin me pershkrimin: 22.1GRAFIKU I PUNIMEVE\\_VIA](#)  
[Bashkangjitur gjeni dokumentin me pershkrimin: 6.1Planet dinamike Prishtina 1 , Ferizaj 1](#)
- 7.5 - AK ka shkelur ligjin duke shpallur fitues OE SALLAHU & SALLILLARI edhe pse tek Aneksi 1 Pika 9.1 dhe 9.2 pika 5 Lista e Paisjeve  
*Lista e pajisjeve sipas aneksit 1 te FDT-se, duhet te jete e noterizuar. Deshmia e kerkuar dokumentare: Duhet të ofrohet një listë e pajisjeve sipas Aneksit 1 te Dosjes se Tenderit, te jete e noterizuar nga noteri,*



verifikimit nga noteri te behet në terren me qellim te verifikimit, ku kjo liste e pajisjeve, duhet te dorzohet në origjinal. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen, marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët, duhet te jete e noterizuar dhe nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe duhet ti referohet aktivitetit ne fjale.

AK ka shkelur ligjin duke qene se OE SALILLARI ne lidhje me verifikimin e paisjeve ne terren nga noteri ka dorezuar nje Deklarate Noteriale ku Noterja Mimoza Shehu thjesht ka vertetuar deklaraten ku ne paragrafin 3 dhe 4 te kesaj deklarate noteriale shkruan: *I cili nen pergjegjesine e tij personale dhe ne vullnet te lire e te plote, ne baze te nenit 79 te Kodit Civil Shqiptar, neni 62, 63, te ligjit nr 110/2018 "Oer biterube: ne deklaroi si me poshte vijon:*

*Me nenshkrimin e ketij akti deklaroi se listat e paisjeve bashkelidhur kesaj deklarate jane ne pronesi te shoqerise Salillari shpk*

- 7.6 - AK ka shkelur ligjin sepse ky kriter i DT nuk eshte plotesuar sipas kerkesave ku eshte kerkuar nje procesverbal i verifikimit te paisjeve ne terren nga noteri dhe jo nje deklarate noteriale nga pronari/drejtuasi i kompanise. *Bashkangjitur gjeni dokumentin me pershkrimin: 7.1Aneksi 1 , Lista e paisjeve*
- 7.7 – Ne DT Paisjet pjesa 1 – Ferizaj 1 - Te lista e makinerise nr.1 Finisher per shtrirjen e asfaltit , Salillari ka paraqitur nje dud doganor qe nuk deshmon se eshte ne pronesi te tij por ne dudin Doganor shihet qarte se Marresi eshte Segment shpk. *Bashkangjitur gjeni dokumentin me pershkrimin: 8.1Finisher\_Dud Doganor*
- 7.8 – Ne DT Paisjet pjesa 4 – Ferizaj 1 - Cilinder vibrues min 1 Ton – Jane vendosur cilindra te peshave te medhaja njeri nga Salillari dhe tjetri nga Sallahu te cilet jane mbi 12Ton. *Bashkangjitur gjeni dokumentin me pershkrimin: 9.1Cilindrat*
- 7.9 - AK ne dosjen e tenderit pika 9.1 & 9.2 Kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale – Kapaciteti teknik dhe profesional 1. Master i ndërtimtarisë ose Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë: 3 vite përvojë punë pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku nje (1) projekte nga lëmia e Mirëmbajtjes, Ndërtimi, Rehabilitimi i Rrugëve. Vlera e projektit të Udhëhequr min. 300,000,00 € e vleres se Ofertës. Të jetë në listën e pagave së paku në gjashtë mujorin e fundit të vitit 2020.  
2. Master i ndërtimtarisë ose Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë: 2 vite përvojë pune pas diplomimit, si udhëheqës i punishtes në projektet e Mirëmbajtjes, Ndërtimi, Rehabilitimi i Rrugëve, minimum nje (1) projekte nga lëmia e kerkuar. Vlera e projektit të Udhëhequr min. 300,000,00 € e vleres se Ofertës. Të jetë në listën e pagave së paku në gjashtë mujorin e fundit të vitit 2020. Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit ose gjeodet (shkolla e lartë), ose Bahcelor i diplomuar i gjeodezisë me tri vite përvojë pune pas diplomimit. Vlera e projektit të Udhëhequr min. 300,000,00 € e vleres se Ofertës. Të jetë në listën e pagave së paku në gjashtë mujorin e fundit të vitit 2020. Inxhinier i diplomuar i komunikacionit me dy vite përvojë pune pas diplomimit ose Bahcelor i diplomuar i komunikacionit me dy vite përvojë pune pas diplomimit. Të jetë në listën e pagave së paku në gjashtë mujorin e fundit të vitit 2020. Dëshmia e kërkuar dokumentare: CV-a e nënshkruar nga Inxhinieri duhet te jetë origjinale. Diploma Univerzitare e noterizuar. Kontrata e punës me ofertuesin, origjinal ose kopje e noterizuar. Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit. Leternjoftimi – kopje, nëse OE aplikon me shume se dy pjese (lot) atëherë duhet te ofrohet stafi edhe per aq lote sa konkurohi.

AK te shpall te pergjegjshem ne lotin Ferizaj 1 per sa kohe te gjithe inxhinieret e ketij OE SALLAHU & SALLILLARI nuk posedojme referencat sipas kushteve te DT dhe gjithashtu inxhinieret nuk jane te percaktuar se kush do te jete projekt menaxher, kush do te jete udheheqes i punishtes.

